



Bazuar në dispozitat 38.3 dhe 38.4 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) shpall:

KONKURS
për
Zëvendësguvernator/e
për Mbikëqyrje Financiare

Zëvendësguvernatori/ja për Mbikëqyrje Financiare është pozitë e lartë ekzekutive (mbi nivelin e drejtorëve të departamenteve). Zëvendësguvernatori/ja për Mbikëqyrje Financiare shërben si anëtar/e i/e Bordit Ekzekutiv dhe e ndihmon Guvernatorin në realizimin e operacioneve të BQK-së. Është i/e ngarkuar me funksionet e BQK-së për licencim dhe mbikëqyrje të bankave, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale dhe institucioneve të tjera financiare. Po ashtu mund të ngarkohet me detyra dhe përgjegjësi shtesë ose portofol tjetër sipas strukturës organizative.

Profili i kërkuar i kandidatit:

- Të jetë shtetas/e i/e Kosovës;
- Të jetë me integritet;
- Të ketë përgatitje universitare në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështjeve juridike;
- Të ketë minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështjeve juridike;
- Të ketë njohuri në zhvillimin dhe implementimin e politikave të rëndësishme të lidhura me objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Të përmbushë kërkesat nga neni 40 i Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Përvoja dhe aftësia menaxheriale relevante paraqet përparësi;
- Përvoja profesionale dhe menaxheriale në mbikëqyrje të institucioneve financiare paraqet përparësi;
- Përvoja në pozita të larta drejtuese në institucione financiare paraqet përparësi;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Dokumentet e kërkuara për pozitën në fjalë:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim (formularin mund ta shkarkoni përmes ueb-faqes: www.bqk-kos.org);
- CV;
- Letër motivuese (ndërlidhni përvojën dhe kualifikimin me pozitën e synuar);
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e ID-së;
- Kopjet e diplomave (të noterizuara), ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura/nostrifikuara zyrtarisht nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Certifikatën nga Gjykata kompetente, e cila dëshmon se kandidati/ja nuk ka qenë asnjëherë subjekt i ndonjë veprë penale (certifikatë kjo jo më e vjetër se 3 muaj); dhe
- Vërtetimin nga Policia që dëshmon se kandidati/ja nuk është nën hetime (vërtetim ky jo më i vjetër se 3 muaj).
- Certifikatat profesionale, rekomandimet dhe referencat relevante (opsionale).

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të lartcekur në e-mail adresën elektronike paneli@bqk-kos.org, duke e vendosur si titull (subjekt): **Aplikimi per Z.G. per Mbikeqyrje Financiare**

Afati i fundit për aplikim është **15 shtator 2023**.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur nga ana e panelit do të ftohen për intervistë.